



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria e Arsimit
Uprava za Obrazovanje//Department of Education

Nr.prot:05/735

Datë: 20.08.2025

Duke u bazuar në nenin 62, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, bazuar në Ligjin Nr.02/L-052 mbi Edukimin Parashkollor, në Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, drejtoresha e DKA-së merr:

VENDIM

**PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR
“ALBIONA ASLLANI” NË GODANC PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026**

Të gjithë fëmijët e prindërve banorë të komunës së Shtimes dhe ata të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë vendim nga mosha 09 muaj deri 5 vjeç mund të regjistrohen në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Godanc. Fëmijët e komunave tjera mund të regjistrohen vetëm atëherë kur nuk plotësohet numri i fëmijëve në institucionin e sipërpërmendur.

Planifikimin e numrit të fëmijëve që do të pranohen në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” e bën vet institucioni në fjalë, në përputhje me infrastrukturën ligjore, kapacitetet fizike dhe profesionale.

Moshën e fëmijëve dhe grup- moshat i përcakton vet Institucioni Parashkollor “Albiona Asllani” në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kapacitetet fizike e profesionale. Llogaritja e moshës bëhet në bazë të datës së fillimit të marrjes së shërbimit e jo me rastin e regjistrimit.

Pranimi i fëmijëve do të bëhet në bazë të numrit të pikëve të grumbulluara sipas kriterëve të poshtëshënuara në tabelë:

Nr	Kategoria/ kriteri	Pikët
01	Fëmijët me të dy prindërit e punësuar	100
02	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	95
03	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
04	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	85
05	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	80
06	Fëmijët e nënave vetushqyese (nëse nëna është e punësuar)	75
07	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse të dy prindërit punojnë	70
08	Fëmijët me njërin prind të punësuar (me përparësi nëna e punësuar)	65
09	Fëmijët me njërin prind të punësuar (babai i punësuar)	60

10	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	55
11	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	50
12	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse njëri prind punon	45
13	Fëmijët e nënave vetushqyese (nëse nëna është e punësuar)	40
14	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	35
15	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	30
16	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	25
17	Fëmijët me nevoja të veçanta (të lehta) nëse asnjëri prind nuk punon	20
18	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar nuk punon	15
19	Fëmija me të dy prindërit me nevoja të veçanta	10
20	Fëmijët me të dy prindërit e papunësuar	5

Vërejtje: Të gjitha kategoritë e përfshira në tabelën e sipërme, duhet të dëshmojnë me dokumente valide nga institucionet përkatëse statusin e tyre.



Drejtoresha e DKA-së
Yllka Fejzullahu